

SPECIFIKIME TEKNIKE

OBJEKTI :“MIRËMBAJTJE INSTITUCIONEVE SHKOLLORE”

BASHKIA POGRADEC

TABELA E PËRMBAJTJES

SEKSION 1 SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

1.1. Specifikime të përgjithshme

- 1.1.1 Njësitë matëse
- 1.1.2 Grafiku I punimeve
- 1.1.3 Punime të gabuara
- 1.1.4 Tabelat njoftuese

1.2. Dorëzimet tek Supervizori

- 1.2.1 Autorizimet me shkrim
- 1.2.2 Sigurimi i vizatimeve të detajeve
- 1.2.3 Dorëzimet tek supervizori
- 1.2.4 Shembuj
- 1.2.5 Vizatimet e punimeve të zbatuara

SEKSION 2 PUNIME PRISHJEJE DHE PASTRIMI

2.1. Pastrimi i kantierit

- 2.1.1 Pastrimi I kantierit
- 2.1.2 Skarifikimi
- 2.1.3 Heqja e pëmëve dhe e shkurreve
- 2.1.4 Prishja e godinave, gardheve dhe strukturave
- 2.1.5 Mbrojtja e vëndit të pastruar

2.2. Punime prishjeje

- 2.2.1 Skeleritë
- 2.2.2 Supervizioni
- 2.2.3 Metoda dhe rradha e prishjes
- 2.2.4 Siguria në punë

2.3. Prishja e elementeve të godinës

- 2.3.1 Prishja e taracave
- 2.3.2 Prishja e mureve të gurit
- 2.3.3 Prishja e mureve të tullës
- 2.3.4 Prishja e dysHEMEVE
- 2.3.5 Prishja e veshjeve me pllaka të mureve
- 2.3.6 Heqja e dyerve dhe dritareve
- 2.3.7 Heqja e zgarave metalike

SEKSION 3 PUNIME DHEU, GËRMIME DHE THEMELET

3.1. Punime dheu

- 3.1.1 Përgatitja e formacioneve
- 3.1.2 Përpunimi i pjerrësisë
- 3.1.3 Drenazhimimi i punimevë të dherave
- 3.1.4 Tolerancat
- 3.1.5 Mbrojtja e punimeve të dheut
- 3.1.6 Punimet e dheut gjatë periudhave të ngricave

3.2. Gërmime për baza dhe themele

- 3.2.1 Gërmimet
- 3.2.2 Mbushjet
- 3.2.3 Përdorimi i materialit të gërmuar
- 3.2.4 Mbushja rreth strukturave

3.3. Themele standarte

- 3.3.1 Themele betoni
- 3.3.2 Themele me gur dhe beton (butobeton)
- 3.3.3 Plinta për kolona

3.4.Ndihmëse për themelet

- 3.4.1 Hidroizolimi i plintave
- 3.4.2 Hidroizolimi i themeleve
- 3.4.3 Drenazhimi perimetral e sipërfaqësor

SEKSION 4 PUNIME BETONI, ARMIMI DHE HEKURI

4.1.Beton i derdhur në vend

- 4.1.1 Kërkesa të përgjithshme për betonët
- 4.1.2 Materialet
- 4.1.3 Depozitimi i materialeve
- 4.1.4 Klasifikimi i materialeve
- 4.1.5 Klasifikimi i betoneve
- 4.1.6 Prodhimi i betoneve
- 4.1.7 Hedhja e betonit
- 4.1.8 Realizimi i bashkimeve
- 4.1.9 Mbrojtja
- 4.1.10 Betoni në kushte të vështira atmosferike
- 4.1.11 Tuba dhe dalje
- 4.1.12 Provat e betonit

4.2.Elementë dhe nën-elementë betoni

- 4.2.1 Arkitrarë të derdhur në vend
- 4.2.2 Arkitrarë të parapërgatitur
- 4.2.3 Trarë të derdhur
- 4.2.4 Breza betoni
- 4.2.5 Kolona
- 4.2.6 Soleta të armuara tip SAP
- 4.2.7 Soleta të parapërgatitura
- 4.2.8 Soleta b/a
- 4.2.9 Shkallë b/a të derdhura në vend
- 4.2.10 Shkallë me elementë me tulla të lehtësuara
- 4.2.11 Mbulesa në hyrjen kryesore
- 4.2.12 Struktura prej b/a

4.3.Kallëpet dhe finiturat e betonit

- 4.3.1 Përgatitja e kallëpeve
- 4.3.2 Heqja e kallëpeve
- 4.3.3 Klasifikimi i finiturave të betonit

4.4.Hekuri

- 4.4.1 Materialet
- 4.4.2 Depozitimi në kantier
- 4.4.3 Kthimi i hekurit
- 4.4.4 Vendosja dhe fiksimi
- 4.4.5 Mbulimi
- 4.4.6 Bashkimi
- 4.4.7 Paranderja

SEKSION 5 STRUKTURA E NDËRTIMIT

5.1.Muret dhe ndarjet

- 5.1.1 Llaç për muret
- 5.1.2 Specifikim i përgjithshëm për tullat
- 5.1.3 Mur mbajtës me tulla të plota 25 cm
- 5.1.4 Mur mbajtës me tulla të lehtësuara
- 5.1.5 Mur ndarës 12 cm

- 5.1.6 Mur mbajtës I brendshëm 25 cm
- 5.1.7 Mur i brendshëm me tulla të lehtësuara 12 cm
- 5.1.8 Mur i brendshëm me tulla të lehtësuara 25 cm
- 5.1.9 Dopjo mur me tulla
- 5.1.10 Dopjo mur me tulla të lehtësuara
- 5.1.11 Mure me blloqe betoni
- 5.1.12 Mure me gurë
- 5.1.13 Mure të thatë (kartongips)
- 5.1.14 Mure zjarrdruues

5.2. Mbulesat

- 5.2.1 Rikonstruksioni I tarracës
- 5.2.2 Tarraca të reja
- 5.2.3 Rkonstruksion catie tradicionale me tjegulla
- 5.2.4 Çati e re tradicionale me tjegulla
- 5.2.5 Çati me tjegulla bituminoze
- 5.2.6 Çati me panele sandëich
- 5.2.7 Membranat hidroizoluese
- 5.2.8 Ulluqet vertikale dhë horizontale
- 5.2.9 Daljet në çati

5.3. Strukturat metalike

- 5.3.1 Të dhëna të përgjithshme
- 5.3.2 Prodhimi
- 5.3.3 Saldimi
- 5.3.4 Lidhja me bulona
- 5.3.5 Ngritja
- 5.3.6 Mbrojtja nga agjentët atmosferikë

SEKSION 6 RIFINITURAT

6.1. Rifiniturat e mureve

- 6.1.1 Suvatim i brendshëm në rikonstruksione
- 6.1.2 Suvatim i brendshëm në ndërtime të reja
- 6.1.3 Suvatim i jashtëm në rikonstruksione
- 6.1.4 Suvatim i jashtëm në ndërtime të reja
- 6.1.5 Patinimi
- 6.1.6 Lyerjë me bojë plastike në rikonstruksion
- 6.1.7 Lyerjë me bojë plastike në ndërtime të reja
- 6.1.8 Lyerjë me bojë hidromat në punime rehabilitimi e të reja
- 6.1.9 Lyerje e mureve me pllaka gipsi
- 6.1.10 Lyerje me bojë vaji në rikonstruksion
- 6.1.11 Lyerje me boje vaji ne ndertime te reja
- 6.1.12 Lyerja e sipërfaqe metalike
- 6.1.13 Lyerja e sipërfaqeve të drurit
- 6.1.14 Veshja e mureve me pllaka, granil, mermer, gurë etj.

6.2. Rifiniturat e dysHEMEVE

- 6.2.1 Riparimi I dysHEMEVE me pllaka
- 6.2.2 Riparimi i dysHEMEVE me llustër çimento
- 6.2.3 DysHëmë më granil të derdhur
- 6.2.4 Shtrimi i dysHEMEVE me pllaka
- 6.2.5 DysHEMEVE me pllaka gres
- 6.2.6 DysHEMEVE me parket
- 6.2.7 DysHEMEVE me PVC ose linoleum
- 6.2.8 Bordurat vertikale dhe aksesorë të tjerë

- 6.2.9 Hidroizolimi i dysHEMEVE
- 6.2.10 DysHEME me parket për sallat e edukimit fizik

6.3. Rifiniturat e shkallëve

- 6.3.1 Riparimi i shkallëve me granil
- 6.3.2 Shkallë betoni veshur me granil
- 6.3.3 Shkallë betoni veshur me mermer
- 6.3.4 Shkallë veshur me PVC ose linoleum
- 6.3.5 Korimanot metalikë
- 6.3.6 Bordurat vertikale dhe aksesore të tjerë

6.4. Dyer dhe dritare

- 6.4.1 Dritaret/informacion i përgjithshëm/kërkesat
- 6.4.2 Komponentët
- 6.4.3 Vendosja në vepër
- 6.4.4 Riparimin i dritareve prej druri
- 6.4.5 Pragjet e dritareve, granil, mermer, të derdhur
- 6.4.6 Dritare druri
- 6.4.7 Dritare duralumini
- 6.4.8 Dritare PVC
- 6.4.9 Dyert/informacion i përgjithshëm
- 6.4.10 Komponentët
- 6.4.11 Vendosja në vepër
- 6.4.12 Kasat e dyerve
- 6.4.13 Dyer të brendshme
- 6.4.14 Dyer të jashtme
- 6.4.15 Bravat
- 6.4.16 Menteshat
- 6.4.17 Dorezat
- 6.4.18 Dyer të blinduara

6.5. Rifiniturat e tavaneve

- 6.5.1 Tavan i suvatuar dhe i lyster me bojë
- 6.5.2 Tavan i varur me pllaka gipsi

6.6. Rifiniturat e tavaneve

- 6.6.1 Mbrojtëse e këndeve të mureve
- 6.6.2 Sipërfaqe prej xhami (kapriatat, vetratat)
- 6.6.3 Elementë me panelë sanduic
- 6.6.4 Mbrojtëset horizontale të mureve (shiritat)

SEKSION 8 PUNIMET ELEKTRIKE

8.1. Specifikimet elektrike të veçanta

- 8.1.1 Aksesoret
- 8.1.2 Tela dhe kablllo
- 8.1.3 Kablli fleksibël
- 8.1.4 Kanalet dhe aksesoret
- 8.1.5 Kutitë shpërndarëse
- 8.1.6 Lidhjet fleksibël
- 8.1.7 Sistemi i kanalëve
- 8.1.8 Llampat dhe ndriçuesit- të përgjithshme
- 8.1.9 Llampat fluoreshente
- 8.1.10 Çelësat e ndriçimit
- 8.1.11 Prizat
- 8.1.12 Njësitë e siguresave

- 8.2.1 Kanalinat dhe mbajtëset
- 8.2.2 Siguresat

Specifikime teknike

1. Ne zerin lyerje per m2 qe perfshin gelqeren, hidromatin, hidroplastikon, bojen e vajit eshte llogaritur si process i pare parapregatitja e sheshimit te siperfaqes.
2. Ne siperfaqet qe do te kryhet lyerja n.q.s kerkohet ti shkohet 2 ose 3 duar ato duhet te realizohen.
3. Per lyerje e kangjellave fillimisht duhet te behet zmerelimi i sip.
4. Ne zerin e pastrimit te oxhaqeve eshte parashikuar largimi i mbetjeve dhe lenja e objektit paster.
5. Ne zerin F.V.dyer e dritare eshte parashikuar heqja e dyerve, dritareve te vjetra dhe dorezimi i tyre ne magazine e NMIPP. Parapregatitja e siperfaqeve per vendosje.
6. Per proceset e tjera te shikohet Nr i analizes e zberthyer cfare procese parashikon.
7. Cilesia e materialeve qe do te perdoren te jete sipas parametrave te percaktuara per secilin material .
8. Materialet e perdorura duhet te kene certifikaten e cilesise dhe vendin e origjines ose firmen e prodhuesit.
9. Cdo process pune qe do te kryhet ne cdo objekt te kontrollohet nga specialistet e fushes .
10. Ne perfundim te punimeve ne cdo objecti te vihete ne dijeni drejtori i instucionit perkates.

Objekti: “Shërbime për mirembajtjen e ndërtesave”, Bashkia Pogradec

Specifikime të përgjithshme

Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

Grafiku i punimeve

Kontraktuesi duhet t'i japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervizori duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar si dhe supervizionin e punimeve.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervizori, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve.

Punime të gabuara

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit.

Tabelat njoftuese, etj.

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç:

Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Supervizori dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip.

Dorëzimet te Supervizori

Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim ” do t’i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Supervizori të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohet që aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Supervizorit do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

Dorëzimet tek supervizori

Kontraktori duhet t’i dorëzojë Supervizorit për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkohej nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t’i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit për të bërë këto pranime.

Mostrat

Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkohej me të drejtë nga Supervizori për inspektim.

Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

Libreza e masave.

Kontraktori do t’i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve. Ky material duhet të përmbajë dokumentat e zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si dhe librezat e masave për çdo volum pune

Shkatërrimet, prishjet, çmontimi dhe heqjet.

Shkatërrimi dhe heqja e strukturave, mbetjeve ekzistuese etj, nga Sipërmarrësi do të kryhet brenda vendit të punimeve siç udhëzohet nga Supervizori i objektit.

Të gjitha materialet me vlerë ripërdorimi nga puna e çmontimit janë dhe do të mbeten pronë e

Bashkisë. Sipërmarrësi do të dorëzojë ato në vendin e caktuar nga Bashkia me shpenzimet e tij.

Të gjitha mbeturinat e dala nga prishjet dhe shkatërrimi do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia. Sipërmarrësi do të jetë totalisht përgjegjës për heqjen dhe hedhjen në përputhje me ligjet e shtetit, planit të menaxhimit mjedisor dhe kërkesave të këtij specifikimi, të të gjithë materialeve që dalin nga shkatërrimet.

Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes se pjesshme, duhet te jene te tilla qe pjesa e struktures qe ka mbetur te siguroje qendrueshmerine e nderteses dhe te pjeseve qe mbeten.

Kur prishja e nderteses ose e elementeve te saj nuk mund te behet pa probleme e ndare nga pjesa e struktures do te perdoret nje metode pune e pershtatshme.

Elementet çeliku dhe struktura betoni te forcuara do te ulen ne toke ose do te prishen per se gjati sipas gjerësisë dhe permasave ne menyre qe te mos bien.

Elementet e drurit mund te hidhen nga lart, vetem kur ato nuk paraqesin rrezik per pjesen tjeter te struktures. Kur prishen elementet, duhen marre masa per te mos rrezikuar elementet e tjere konstruktive mbajtes, si dhe mos demtohen elementet e tjere.

Ne pergjithesi, puna e shkaterrimit duhet te filloje duke hequr sa me shume ngarkesa te panevojshme, pa nderhyre ne elementet baze struktural.

Pune te kujdesshme do te behen per te hequr ngarkesat kryesore nen kushtet me te veshtira. Seksionet e tjera qe do te prishen do te transportohen nga ashensore, pastaj do te ndahen dhe do te ulen ne toke nen kontroll.

Prishjet në përgjithësi

Prishja pjesore ose në tërësi e çfarëdolloj ndërtese përmban:

- Mekanizmat mbështetës, skelari dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për të krijuar kushte të sigurta për punonjësit dhe publikun.
- Rrethim të përkohshëm të objektit
- Rregullime të dëmtimeve të mundshme shkaktuar nga punimet dhe rregullime të linjave të shërbimeve private apo publike
- Largimi i materialeve dhe mbetjeve të krijuara nga prishjet përfshirë transportin dhe grumbullimin e tyre në vende të autorizuar.

Heqja e materialeve

Heqja pjesore ose në tërësi e çfarëdolloj materiali në një ndërtesë përmban:

- Mekanizmat e duhur, skelari dhe të gjitha pajisjet e nevojshme për të krijuar kushte të sigurta për punonjësit dhe publikun.
- Rrethim të përkohshëm të objektit
- Rregullime të dëmtimeve të mundshme shkaktuar nga punimet dhe rregullime të linjave të shërbimeve private apo publike
- Largimi i materialeve dhe mbetjeve të krijuara nga prishjet përfshirë transportin dhe grumbullimin e materialeve në vende të autorizuar.
- Seleksionimi dhe pastrimi i materialeve të hequra që mund të ripërdoren
- Depozitimi i materialeve përbrenda kantierit
- Largimi i materialeve të papërdorshme përfshirë transportin dhe grumbullimin e tyre në vende të autorizuar.

Hedhja e materialeve

I gjithë materiali i mbetur (mbeturinat) do të hidhet nga Sipërmarrësi në zona të siguruar prej tij dhe të miratuara nga Supervizori i objektit.

Çdo material i planifikuar për të mbetur pronë e Bashkisë, ose do të grumbullohet në grumbuj të pastër ose do të ngarkohet dhe do të transportohet tek zonat e planifikuara për ruajtje. Sipërmarrësi inkurajohet

të bashkëpunojë me autoritetet vendore në përcaktimin e përdorimeve të mundshme për ndonjë material të hedhur dhe në ngritjen e zonave të ruajtjes.

Siguria ne pune

Kontraktori duhet te sigurohet se vendi dhe paisjet jane:

- a. Te nje tipi dhe standarti te pershtatshem duke iu referuar vendit dhe llojit te punes qe do te kryhet.
- b. Te siguar nga nje drejtues teknik kompetent dhe me eksperience.
- c. Te ruajtur ne kushte te mira pune gjate perdorimit.

Gjate punes prishese te suvatimeve dhe te shtresave te taraces se shkolles gjithë punetoret duhet te vishen me veshje te pershtatshme mbrojtese ose mjete mbrojtese si: helmata, syze mbrojtese, mbrojtese veshesh dhe bombola frymemarrjeje.

Heqja e dyerve dhe dritareve

Heqje dyersh dhe dritaresh, qe realizohet para prishjes se suvase ose mureve, duke perfshire kasen, telajot, etj. sistemimin e materialit qe ekziston brenda ambientit te kantierit dhe grumbullimin ne nje vend te caktuar ne kantier per riperdorim.

Prishje e suvatimit

Goditje e te gjithë siperfaqes se suvatuar dhe gjetje e pjeseve te mufatura dhe te plasaritura nepermjet tingullit, prishjet e ketyre pjeseve deri ne daljen e muratures ne mure dhe tavane, larje e siperfaqeve te prishura me uje me presion, duke perfshire skelat e sherbimit ose skelerine, spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te shkolles si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhene plotesisht fund hedhjes se suvase.

Prishje mur tulle

Prishje e muratures me tulla te plota ose me vrime, e çfaredo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar dhe e riveshur me pllaka majolike, e kryer me çfaredo mjeti dhe çfaredo lartësie ose thellesie, perfshire skelen e sherbimit ose skelerine, armaturat e mundeshme per te mbeshtetur ose mbrojtur strukturat ose ndertesat perreth, riparimi per demet e shkaktuara ndaj te treteve per nderprerjet dhe restaurimin normal te tubacioneve publike dhe private (kanaleve te ujrave te zeza, ujin, dritat) pa venien menjane dhe pastrimin e tullave per riperdorim, por me spostimin e materialit brenda ambientit te kantierit si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhene fund plotesisht prishjes.

Prishje e shtreses horizontale te hidro-izolimit te tarraces me zhvillime vertikale, edhe ne pranine e oxhaqeve, e ndertuar nga tre shtresa te mbivendosura leter katramaje, duke perfshire heqjen e kapakeve te parapetit e te çdo pjese metalike dhe venien menjane e spostimin ne kantier te materialeve qe formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhene fund heqjes se tarraces.

Prishja e suvase ne siperfaqet vertikale deri ne nje lartësi, te pakten 30 cm, deri ne dalje ne dukje te muratures, per vendosjen e guaines.

Prishje e dysHEMEVE

Prishje e dysHEMEVE te çfaredo lloji, duke perfshire prishjen e shtreses se llaçit qe ndodhet poshte tyre dhe spostimin e materialeve qe rezultojne brenda ambientit te kantierit.

Heqje zgara hekuri

Heqje e zgarave te hekurit te çfaredo lloji, por me spostimin e materialit qe rezulton, brenda ambientit te shkolles, kopshtit duke perfshire perzgjedhjen e mundeshme (te percaktuar nga D.P) dhe venien menjane ne nje vend te caktuar te kantierit per riperdorim.

Sistemimi i tarraces

Sistemim i planit aktual te pjerresive per pjeset e prishura, duke perdorur llaç çimentoje me 1:2, mbi te cilen do te realizohet nje shtrese llaç çimento, dhe me dozim, e niveluar ne menyre perfekte per pergatitjen e siperfaqes ku do te vihete hidro-izoluesi. Riberje e shtreses se suvatimit vertikal, e niveluar. Shtrese hidro-izoluese, mbi siperfaqe te thare dhe te niveluar si me siper, duke perfshire pjesen vertikale, trajtuar e nje hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama si dhe çdo detyrim tjeter te nevojshem per t'i dhene fund punes ne menyre perfekte. Sistemim i oxhakut duke perfshire çdo detyrim dhe mjeshteri.

Riberje e nje shtrese finale suvatimi mbi pjeset vertikale te guaines. Rivenie ne veper te kapakeve te parapetit te hequra me pare duke perfshire sistemimin e mundshem te saj, ngjitjen me llaç marke m-1:2, stukimin dhe çdo gje tjeter te nevojshme per ta realizuar dhe perfunduar punen ne menyre perfekte.

Tarraca

Formimi i pjerresive mbi siperfaqen plane me nje shtrese izoluesi termik me trashesi te ndryshme per te patur nje pjerresi sipas udhezimeve me llaç çimento 1:2.

Shtrese llaç çimento mbi pjerresine e pershkruar me siper, me trashesi minimale 2 cm e realizuar me llaç çimento m-1:2, me dozim per m³ e niveluar ne menyre perfekte per pergatitjen e siperfaqes mbi te cilen do te vihete hidro-izoluesi.

Shtrese hidro-izoluese, mbi siperfaqe te thare dhe te niveluar si me siper, duke perfshire pjesen vertikale, trajtuar me nje dore praimer, e perbere nga dy membrana guaine te formuar nga nje shtrese fibre prej leshe xhami dhe bitumi, me trashesi **4,5 mm secila**, te vendosura ne veper me flake, te kryqezuara ne siperfaqe te rrafshet, te pjerret ose vertikale deri poshte kopertines perfshire mbivendosjen e lidhjeve (minimumi prej 12 cm, punet e perkohshme per te gjithë kohezgjatjen e punes, e perbere nga strukture druri ose hekuri dhe siper saj me nje pelhure te papershkrueshme ose te ngjashme per mbrojtjen nga shiu, qe do te aplikohet ne siperfaqen mbi te cilen po punohet, si dhe heqjet, spostimet, mberthimet etj. si dhe çdo detyrim tjeter te nevojshem per t'i dhene fund punes ne menyre perfekte.

Vendosja ne veper e kapakeve te parapetit me kanal kullimi shiu, me beton dhe te armuar ne menyre te rregullt, i parafabrikuar ose i hedhur ne veper, sipas udhezimeve ne projekt, m-200 dhe dozim sipas pikes 2.4, perfshire kallepet, perforcimet dhe çdo detyrim tjeter te nevojshem per ti dhene fund punes ne menyre perfekte.

Punimet me dhera

Qëllimi

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresa) dhe gërmimet për struktura në kanale.

Më tej ai mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina.

Përcaktimet

Përcaktimet e mëposhtme duhet të aplikohen:

DHERAT

Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahe (përfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

MATERIALE TE PËRSHTATSHME

Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me kontratën e punimeve dhe që janë në gjendje të ngjeshen në një mënyrë të specifikuar për të formuar mbushje ose trase.

Pastrimi i sheshit

Të gjitha sheshet ku do të punohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, ferrat, rrënjët e mëdha, plehurat dhe materiale të tjera sipërfaqësore.

Të gjitha këto materiale do të spostohen dhe largohen në mënyrë që të jetë e pëlqyeshme për Punëdhënësin. Të gjitha pemët dhe shkurret që janë përcaktuar nga Punëdhënësi që do të ngelen do të mbrohen dhe ruhen në mënyrën e aprovuar.

Të gjitha strukturat ekzistuese të identifikuar për tu prishur do të largohen sipas udhëzimeve të Supervizorit të Punimeve.

Kjo do të përfshijë dhe spostimin e themeleve të ndërtimeve që mund tëndeshen.

Sipërmarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e vijave ekzistuese të ujit, rrethimeve dhe shërbimeve që do të mbeten në sheshin e ndërtimit.

Lëndët e dëmshme

Të gjitha agregatet do të jenë të lira në mënyrë të arsyeshme nga kokrrat e argjilës, pjesët e buta dhe të shkrufta, kripta, alkalinet, lëndët organike, shtresat aderente, dhe substanca të tjera të papërcaktuara të cilat mund të përmbajnë karakteristika të padëshirueshme.

Pesha e substancave të dëmshme nuk do të kalojë përqindjet e mëposhtme:

Trashësia e shtresës

Trashësia e nënbazës do të jetë e tillë siç kërkohet për të arritur tolerancat e nivelit të specifikuar më sipër duke pasur parasysh nivelet aktuale të shtresave të mëposhtme.

Materialet

Materiali që do të përdoret duhet të jetë material bazë shkëmb i thyer i përfunduar nga rezerva të pa ekspozuara, material i masivëve të shkëmbinjve natyral dhe do të jenë të lirë nga bimësia, material të huaja dhe materiale të tjera të rrezikshme.

Sipërmarrësi do të jetë plotësisht përgjegjës për furnizimin e materialeve të përdorura si baze agregate nën këtë seksion.

Vendosja

Kur trashësia e specifikuar kompakte (e ngjeshur) e nënbazës është më e madhe se 200 mm, nënbaza do të ndërtohet në dy ose më shumë drejtime. Përndryshe, nënbaza mund të ndërtohet në një shtresë të vetme dhe trashësia kompakte e çdo shtrese të shtruar, të përpunuar dhe kompakte në të njëjtën kohe, nuk do të kalojë 200 mm dhe as nuk do të jetë më shumë se 100mm.

Tolerancat

Tolerancat për përfundimin e sipërfaqes së bazës ndryshojnë në varësi të tipit të sipërfaqes që do të aplikohet. Aty ku baza do të marrë një veshje sipërfaqeje si sipërfaqe përfundimtare, tolerancat e kërkuara janë:

Niveli (Veshja e sipërfaqes)

Niveli i përfunduar i bazës nuk do të jetë më pak se niveli i Objektivit i treguar tek skicat dhe jo më shumë se 10mm mbi nivelin e Objektivit. Duke kontrolluar për përputhshmëri me këto tolerance nivelesh, Supervizori më parë do të vendosë nivele të bazuara në një model rrjeti koordinativ i cili nuk ka lidhje me rrjetin koordinativ të përdorur për kontrollin e nivelit në kryerjen e punimeve dhe më tej do të procedojë për të kontrolluar çdo pikë, ekzaminimi viziv i së cilës sugjeron se mund të jetë jashtë tolerancës ose për të cilën testi me mastar tregon se duhet të ketë dyshime.

Rregullsi (veshja e sipërfaqes)

Përveç përputhjes me kërkesat e mësipërme për tolerancën e nivelit, sipërfaqja e përfunduar e drejtimit të bazës do të kontrollohet po ashtu për rregullsi me një mastar 3 m. Kur shtrihet mbi sipërfaqen e drejtimit të bazës në ndonjë vend paralel me drejtimin qendror të rrugës dhe në ndonjë vend të tërthortë tek buza e jashtme e rrugës, asnjë pjesë e buzës së fundme të mastarit nuk do të jetë më shumë se 5mm sipër sipërfaqes së përfunduar të bazës.

Pllakat

Të përgjithshme

Ky seksion mbulon kërkesat dhe procedurat për shtrimin me pllaka, që parashikohet të ndërtohen sipas kërkesave të Kontrates.

Materialet për pllakat

Pllakat duhet të jenë të cilësive I, të prodhuara në fabrike me permasat e percaktuara në përputhje me llojin e pllakës. Pllakat duhet të jenë pa plasaritje, pa demtime të sipërfaqes dhe të buzeve.

Asnjë material nuk do të përdoret nga Sipërmarrësi pa miratimin e Supervizorit të punimeve

Shtrimi

Shtrimi me pllaka.

Shtrimi me pllaka do të jetë shtresa perfundimtare e objektit. Shtrimi do të bëhet me urdher me shkrim nga Supervizori i objektit pas verifikimit të cilësive dhe nivelit të vendit ku do të kryhet shtrimi.

Sipërmarrësi do të kryejë të gjitha punimet ndihmëse, si pastrimi para dhe pas shtrimit, nivelimi, rakordimi në zonat e caktuara.

Sipërmarrësi do mbrojë gjithë kohën shtresat e pllakave nga demtimet. Çdo demtim gjatë periudhës së punimeve do të riparohet menjëherë.

Shtresë pllaka gres

Nuk duhet të jenë të lëmuara në mënyrë që të shmanget rrëshqitja.

Duhet të jenë rezistente ndaj gërvishjeve (kategoria 4) dhe të kenë koeficientin më të lartë të mundshëm kundër rrëshqitjes.

BETON

Betoni për strukturat & përdorime të tjera

Përshkrim

Ky seksion mbulon materialet, projektimin e miksurave, perzieresin, transportin, vendosjen, konsolidimin dhe kurimin e betonit që kërkohej për Punimet. Ai gjithashtu përfshin kallpet dhe vendosjen e betonit.

Përkufizimet

Betoni i strukturës do të prodhohet prej materiali në përputhje me specifikimet, dhe betoni i përdorur vetëm për mbushje gropash, themele të shkelqyera dhe qelime të tjera të ngjashme për të cilin nuk janë specifikuar kërkesa të forta nuk do të jetë subjekt i shtrirjeve domethënëse.

Një derdhje i referohet procesit të vendosjes së betonit në një kallëp, shtrat derdhjeje, etj. dhe gjithashtu për mbushjen e volumnit. Dërdhjet në drejtimin vertikal janë referuar sipas radhës.

Materialet për Beton

Te përgjithshme

Sipërmarrësi do të paraqesë Supervizorit të objektit gjithë detajet mbi gjithë materialet që ai propozon për të shfrytëzuar në përputhje me kontratën. Këto detaje do të përfshijnë llojin e kategorinë e materialit, duke përfshirë standartin apo specifikimin, burimin e materialit të marrë, (impiantin, guroren, apo të tjera) etj., të gjitha në përputhje me kërkesat e specifikimeve në fjalë. Materialet e ndërthitura në beton do të certifikohen nga burimi që janë marrë dhe do të jenë konform me gjithë kërkesat e specifikimit.

Asnjë beton nuk do të vendoset në struktura deri sa Supervizori i objektit të aprovojë materialet me të cilat duhen përdorur. Materialet e aprovuara nuk do të alternohen ose zëvendësohen me material të tjerë pa miratimin me shkrim të Supervizorit të objektit.

Proporcionet e perzieresve të betonit

Që në fillim të punimeve duhet që Sipërmarrësi të tregojë llojin e makinerisë për ngjeshjen e

betonit, makinerine qe ai ka ndermend ta perdore ne pjese te ndryshme te Punimeve dhe te marre miratimin e Supervizorit te objektit mbi to.

Sipermarresi do pergatise perzieres per betonin ne gradet e kerkuara per secilin projektim dhe qe permbush kerkesat e meposhtme:

Cemento, agregate dhe uje qe duhet te jene ne perputhje me klauzolat e duhura per kete specifikim. Cemento do kete perberje mterialesh aq sa eshte treguar ne tabele.

Permbajtja e ujit per secilen perzieres do jete e tille qe te jape rezultatin e kerkuar (faktorin e ngjeshjes).

Atje ku ka nevojte per metoda te ndryshme aplikimi per te njejtin nivel betoni, do merren faktore te ndryshem ngjeshje, e me pas do pergatitet nje perzieres i vecante per secilin rast, per te plotesuar kerkesat e duhura per klauzolen e ketij Specifikimi.

Provat per Perzieresit

Kontraktori do pergatise ne prezence te Supervizorit te objektit, nje prove per perzieresin e seciles klase per betonin. Perqindjet aktuale do percaktohen ne baze te provave te perzieresve te pergatitura nga Sipermarresi dhe te kryera me materialet e perdorura per Punimet. Secili grupim nuk do jete me pak se gjysem meter kub ne peshe para se te perzihet dhe duhet te perzihet sic tregohet ne keto Specifikime ne nje perzieres mekanik te llojit te miratuar per tu perdorur ne Punime. Tre grupime te vecanta te betonit do pergatiten per secilen prove perzieresash.

Faktoret e ngjeshjes per cdo grumbull do te caktohen menjehere pas perzierjes sic drejtohen nga BS 1881 dhe BS EN 12390 dhe nuk do te kaloje maksimumin e vleres se kerkuar ne projektin e perzierjes. 150mm kubik testesh te ngjeshur do te behen nga secili grumbull i perzierjes se provuar.

Kubiket do te behen, trajtohen dhe ruhen dhe testohen ne perputhje me kerkesat e SSH/BS 1881 dhe SSH/BS EN 12390 . Tre kubet do te testohen 7 dite pas fabrikimit dhe tre te tjerat 28 dite pas fabrikimit.

Projekti perzieres i cili ploteson kerkesat e ketyre Specifikimeve per nje grade te vecante te betonit do te quhen perziere e aprovuar per gradat e betonit dhe Sipermarresi do te perdore vetem perzierjen e aprovuar kur grada e betonit eshte specifikuar dhe do te filloje pa lejen me shkrim te Supervizorit te objektit.

Nese do te kete ndonje ndryshim ne material ose ne proporcione te materialit qe do te perdoret Supervizori Objektit do te kerkoje perzierje tjeter te provuar dhe testet e metjshme te kubikeve nuk do te behen para se merret leja me shkrim.

Kontraktori do te jape mendimin per te permbushur detyren e tij qe materialet mbi te cilat ai ka kuotuar do te prodhojne nje beton i cili me proporcione formale te specifikuara dhe rregullimet e metejshme sic tregohet nga perzierja e testuar, do te zhvilloje fuqine e kubikeve te specifikuar dhe ne te njejtin kohe punuesmerine e deshiruar ne punime.

Kontrolli i cilesise se betonit

Kontrolli nga Supervizori i objektit dhe Miratimi i Materialeve, etj

Para perdorimit ne punime, Sipermarresi duhet te tregojte per Supervizorin e Projektit qe i gjith materialit dhe metodat e ruajtjes dhe miksimit te perdorura ne prodhimin e betonit jane konform me kerkesat e Specifikimeve. Te tilla dorezime te materialeve ne terren sic vendos Supervizori i objektit do te testohen dhe anlizohen per te siguruar qe ato jane ne pajtueshmëri dhe testet do te kryhen ne fillim te punes se tyre per te lejuar rezultatet te studiohen dhe materialet te aprovohen, modifikohen dhe te anulohen sipas mendimit te Supervizorit. Sipermarresi duhet te largoje te gjith materialit e anuluar ne terren pa vonesa me shpenzimet e tij. Lejimi per te perdorur ndonje material nuk do te jepet, dhe nuk do te behet asnje perjashtim.

Punimet riparuese kur rezultojne gabim

Nese gjate heqjes se ndonje kallepi, sipërfaqja e betonit del te jete difektoze, Sipermarresi duhet pa u vonuar te rregulloje te tilla difekte para inspektimit te Supervizorit te Objektit. Sipërfaqet difektoze nuk do te rregullohen me suvatim.

Zonat te cilat Supervizori Objektit bie dakort qe te riparohen, do te jene perseri me beton baze.

Pas pastrimit me uje dhe ajer te ngjeshur do te hidhet nje shtrese e holle me llac cemento e cila do te perhapet me furce ne faqet e ekspozuara te betonit te se njejtës klase si trupi kryesor por me agregate me te vegjel se 19 mm qe eshte madhesia formale.

Nese riparimet jane bere ne me shume se 10 dite pasi betoni eshte hedhur, betoni i riparuar duhet te jete beton epoksid dhe ngjitja midis betonit ekzistues dhe te ri do te arrihet duke perdorur nje komponent lidhes epoksid te aprovuar.

Parregullsite e siperfaqes, te cilat jane jashte limiteve te tolerances do te ulen ne menyren e sugjeruar nga Supervizori i objektit.

Defekte te tjera do te zgjidhen me instruksionet e Supervizorit te objektit.

Ne te gjitha rastet aty ku puna e betonit deshton nga kerkesat e specifikimeve dhe riparimet ne perputhje me detajet e dhena nuk jane te mundura, ose kur Sipermarresi nuk mund te ekzekutoje te tilla riparime me kompetence atehere Supervizori i objektit ka te drejten te urdheroje qe punet difektoze te ribehen plotesisht dhe rivendosen nga Sipermarresi pa asnje shpenzim te punedhensesit.

Kurimi i betonit

Te pergjithshme

Gjate trajtimit te betonit do te merren te gjitha masat per te siguruar mungesen e plasaritjeve.

Temperatura e siperfaqes te betonit nuk do te jete subjekt i ndryshimeve te menjehershme nepermjet sprucimit te ujit te ftohte dhe betoni duhet te jete i mbrojtur nga dielli dhe era. Betoni i sapo vene duhet te jete i mbrojtur nga shiu.

Kurimi me uje

Rendesi te madhe ka trajtimi i sakte i betonit te fresket dhe Kontraktori duhet te siguroje qe ai te kryhet efektivisht. I gjithë betoni i ri i vendosur duhet te mbrohet nga efeket e shiut, eres se thate dhe diellit nepermjet rrjetave te pershtatshme, te mbeshtetura mbi struktura, deri sa betoni te ngurtesohet mjaftueshem.

Sapo betoni te jete ngurtesuar mjaftueshem per te mbeshtetur mbulesen, ai do te mbulohet me thase te paster ose nje shtrese te trashë rere te paster 50mm ose material tjetër te aprovuar i cili do te mbahet vazhdimisht ne kushte lageshtie me sprucim me uje te fresket.

Trajtimi i gjithë betonit do te vazhdoje per te pakten 7 dite ose sic udhëzohet nga Supervizori i Objektit.

Kurimi i here pas hershem

Si nje metode alternative e trajtimit, siperfaqja mund te mbrohet, me aprovim te Supervizorit te Objektit, duke u trajtuar me perzierje rreshire te aprovuar, sprucim mekanik mbi siperfaqen e betonit te perfunduar ne nje grade te aprovuar nga Supervizori Objektit, sa te jete e mundur per te prodhuar nje membrane me trashesi uniforme.

Vetem nese udhezohet nga Supervizori i Objektit, perzierja do te aplikohet menjehere pas perfundimit te shtrimit dhe perfundimit te betonit.

Kallepet per betonin

Ndertimi i kallepeve

Kallepet do te perfshijne te gjithë format e perkohshme ose te perhershme te kerkuara per formimin e betonit se bashku me ndertimin e perkohshem kerkuar per mbeshtetjen e tyre.

Te gjithë kallepet do te ndertohen ne menyre qe te mos kete asnjë rrjedhje ose humbje te materialit beton. Pas ngurtesimit do te jete ne pozicion dhe ne forme, dimension dhe sipërfaqe, i mbaruar sic pershkruhet ne Kontrate.

Me lidhjen e materialit beton brenda tyre, pjeset e kallepeve do te hiqen pa asnje demtim te betonit dhe gropat e mbetura do te mbushen me llac.

Pergatitja e kallepeve para betonimit

Siperfaqet e brendshme te kallepeve pervec kallepeve te perhershem do te vishen me nje material te aprovuar per te parandaluar adezionin e betonit. Agjente te tjete, te ndryshem, nuk do te perdoren ne kallepet per beton ne rast se jane te dukshmem ne perfundimin e punes.

Menjehere para betonimit te gjitha kallepet do te pastrohen.

Heqja e kallepit

Supervizori Objektit do te jete i informuar kur Sipermarresi ka si qellim te heqe ndonje kallep. Koha ne te cilen kallepet mund te hiqen do te jete pergjegjesia e Sipermarresit, por periudha minimale midis betonimit dhe heqjet se kallepeve do te jete si me poshte:

Periudha kryesore

Anet e mureve, 1 dite

shufrat, kollonat dhe tubat

Jasteke dhe soleta 7 dite

Nen soleta 14 dite

Periudhat e reguara me siper jane bazuar ne nje temperature konstante te siperfaqes te betonit prej 16° C dhe perdorimit te cimentos Portland. Ato mund te ndryshojne nese jane perdorur tipe te tjera cimentoje, subjekt i marreveshjes me Supervizorin e objektit.

Armaturat do të ndërtohen në mënyrë të tillë që të mbrojnë betonin kundër dëmtimeve nga uji. Aty ku mendohet se kallepet do te riperdoren ato duhet te pastrohen.

Dozaturat e llaçit dhe te betonit ne m³

1. LLAÇI

- 1.1 Llaç bastard marka 15 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me çimento, gelqere, rere ne raporte 1:0.8:8.

Gelqere e shuar It 110, çimento 300 kg 150, rere m3 1,29.

- 1.2 Llaç bastard marka 25 me rere natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me çimento, gelqere, rere ne raporte 1:0.5:5.5

Gelqere e shuar It 92, çimento 300 kg 212, rere m3 1.22.

- 1.3 Llaç bastard marka 15 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento, gelqere, rere ne raporte 1:0.8:8.

Gelqere e shuar It 105, çimento 300 kg 144, rere m3 1.03.

- 1.4 Llaç bastard marka 25 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento, gelqere, rere ne raporte 1:0.5:5.5.

Gelqere e shuar It 85, çimento 300 kg 206, rere m3 1.01.

- 1.5 Llaç bastard marka 1:2 me rere te lare (porozitet 35%) e formuar me çimento, rere ne raporte 1:2. Çimento 400 kg 527, rere m3 0.89)

Dozaturat e mesiperme jane te vlefshme per 1(nje) m³ llaç. Ato jane marre nga Manuali Nr.1 "Analiza teknike per prodhimin e materialeve te ndertimit, keshilla dhe udhezim", te Datuar, Tirane Dhjetor 1992 (Republika e Shqiperise-Ministria e Ndertimit)

Betoni

- 2.1 Beton marka 100 me zhavorr natyror:

Çimento 300 kg 240, zhavorr m³ 1.05, uje m³ 0.19

- 2.2 Beton marka 100 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri ne 20 mm, rere e lare me modul 2.6: Çimento 300 kg 240, rere e lare m³ 0.45, granil m³ 0.70 , uje m³ 0.19.
- 2.3 Beton marka 150 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri ne 20 mm, rere e lare me modul 2.6: Çimento 400 kg 260, rere e lare m³ 0.44, granil m³ 0.70 m, uje m³ 0.18
- 2.4 Beton marka 200 me inerte, konsistence 3-5 cm, granil deri ne 20 mm, rere e lare me modul 2.6: Çimento 400 kg 300, rere e lare m³ 0.43, granil m³ 0.69 m³, uje m³ 0.18

Vepra te perkohshme

- 3.1 Skela metalike tubolare e tipit kavalet, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, transportet, mbetjet, vendosjet ne veper, mberthimin, çmontimin, etj. per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire perforcimin me pahi dhe te formuar nga derrasa me trashesi 5 cm, per nje rradhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat mbrojtese dhe çdo gje tjeter te nevojshme per sigurimin e punetorit. N.q.s eshte e nevojshme rrethimin e skelave te jashtme nga ana e rruges, me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave ne kembet, ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjithë kohezgjatjen e skeles ne veper, çmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundeshme, tabelat dhe dritat.
- 3.2 Skele metalike tubolare, e montuar me tuba te rumbullaket dhe lidhje, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, trasportet, mbetjet, vendosjet ne veper, mberthimin, çmontimin etj. per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire perforcimin me pahi dhe te formuar nga derrasa me trashesi 5 cm, per nje rradhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat mbrojtese dhe çdo gje tjeter te nevojshme per sigurimin e punetorit. N.q.s eshte e nevojshme rrethimin e skelave te jashtme nga ana e rruges, me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave ne kembet, ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjithë kohezgjatjen e skeles ne veper, çmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundeshme, tabelat dhe dritat.
- 3.3 Skele derrase, e montuar me binare dhe derrasa, e ndertuar sipas normave teknike ne fuqi, perfshire ngarkimet, shkarkimet, trasportet, mbetjet, vendosjet ne veper, mberthimin, çmontimin etj. per nje lartesi deri ne 12 m, duke perfshire perforcimin me pahi dhe te formuar nga derrasa me trashesi 5 cm, per nje rradhe te vetme te skeles dhe nenskeles, parmakun, telat mbrojtese dhe çdo gje tjeter te nevojshme per sigurimin e punetorit. N.q.s eshte e nevojshme rrethimin e skelave te jashtme nga ana e rruges, me ane te llamarines se valezuar, te larta jo me pak se 2m, duke perfshire firot, hapjet ne terren per mbeshtetjen e kembeve dhe fiksimin e tyre, gozhdimin dhe lidhjen e llamarinave ne kembet, ne bordet e poshtme dhe te siperme, per te gjithë kohezgjatjen e skeles ne veper, çmontimin dhe heqjen ne fund te punes, duke perfshire shenjat e mundeshme, tabelat dhe dritat.

Trajtimi i menjehershëm i siperfaqeve

Cdo lloj trajtimi i menjehershëm ne sipërfaqe, ne përputhje me sugjerimet e Supervizorit te objektit, pas nje inspektimi te menjehershëm gjate heqjes se kallepit, duhet te ndermerret pa asnje vonese.

Secila pjese e betonit siperfaqja e se ciles eshte trajtuar si rezultat i inspektimit nga Supervizori i objektit, duhet te kontrollohet gjithmone.

Punime hidroizolimi dhe çati

Zëvendësim tjegulla çatie

Tjegullat e reja do te zevendesojne ato te thyera dhe te demtuara aty ku do te jete e domosdoshme.

Përpara fillimit të punimeve të zëvendësimit të tjegullave të çatisë, kryhen punimet prishëse. Në punimet prishëse duhet patur parasysh, që të largohen të gjitha elementet mbajtëse, që janë të dëmtuara ose të kalbura dhe të zëvendësohen ato me të reja, të cilat t'i plotësojnë KTZ. Përpara se të fillojë puna për vendosjen e tjegullave, duhet që të bëhet një kontroll i imtësishëm nga ana e Supervizorit për gjendjen e elementeve mbajtës dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij, mund të fillojë puna.

Pastrim, zhbllokim oxhaku + largim mbeturina, përmban plotësimin e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në një cilësi sa më të mirë. Mbeturinat e dala nga pastrimi i oxhaqeve do të transportohen në vendin e percaktuar nga Bashkia.

Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 kk

Materiali duhet të jetë prodhuar nga fabrika të licensuara. Duhet të dorëzohet i paketuar dhe të shoqërohet me certifikatat përkatëse të cilësisë. Në paketimin e tyre duhet të duket dhe të lexohet qartë prejardhja e tyre, lloji dhe firma prodhuese, dhe të ruhen (magazinohen) deri në përdorimin e tyre sipas specifikimeve përkatëse. Përpara shtrimit, duhet që sipërfaqet të jenë të pastrura mirë.

Mbivendosja e shtresave kryhet sipas udhëzimeve të prodhuesit, por bashkimet e shtresës së pare nuk duhet të përputhen me bashkimet e shtresës së dytë. Nuk lejohet vendosja e tyre në temperature më të ulëta se 5° C. Ngjitja kryhet me flakë.

Shtresë llustër çimento 1:2

Duhet të merren të gjitha masat për shtrimin sa më të mirë, për sigurimin e pjerrësive të nevojshme, për shmangjen e plasaritjeve duke krijuar një shtresë të qëndrueshme, të lëmuar dhe të sheshtë dhe në gjendjen më të përshtatshme për vendosjen e shtresave mbi të. Trashësia e shtresës duhet të jetë e tillë që të sigurohet qëndrueshmëria e saj ndaj ngarkesave.

Bërje suva e brendshme, përmban:

Shtresa e suvasë përbëhet nga llaç i markës 25, me trashësi 2 cm dhe në dozat e mëposhtme për m²: 0.005 m³ rërë e pastër e imët, 0.03 m³ llaç (i tipit 1:2), 6.6 kg çimento (marka 400), ujë. Plotësimin e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në një cilësi sa më të mirë.

Bërje suva e jashtme e thjeshtë

Shtresa e suvasë përbëhet nga dozat e mëposhtme për m²: 0.005 m³ rërë e larë lavatriçe, 6.6 kg çimento 32.5N, 0.025 m³ llaç i përzier M25. Plotësimin e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në një cilësi sa më të mirë.

F.V. dyer duralumini pa xham

Furnizimi dhe vendosja e dyerve dimensionet e të cilave do të merren nga Kontraktuesi, përbëhen nga:

- Kornizat të cilat fiksohen në mur
- Vendosja kryhet pas përfundimit të suvatimit dhe lysterjes
- Duhet të ketë bravë metalike dhe të shoqërohen me tre kopje çelsash
- Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë
- Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

F.V. dritare duralumini tek xham

Furnizimi dhe vendosja e dritareve dimensionet e të cilave do të merren nga Kontraktuesi, përbëhen nga:

- Kornizat të cilat fiksohen në mur
- Furnizimi me dritare
- Vendosja dritareve kryhet pas përfundimit të suvatimit dhe lysterjes
- Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë
- Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

F.V. derye+vetratë duralumini tek xham

Furnizimi dhe vendosja e dyerve dimensionet e të cilave do të merren nga Kontraktuesi, përbëhen nga:

- Kornizat të cilat fiksohen në mur
- Vendosja kryhet pas përfundimit të suvatimit dhe lyerjes
- Duhet të ketë bravë metalike dhe të shoqërohen me tre kopje çelsash
- Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë
- Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

Punime bojatisjeje

Lyerje me sherbet gëlqere, përmban:

Fshirjen e sipërfaqes së suvatuar që do të lyhet.

Mbulimin e sipërfaqeve që nuk do të lyhen me shirit letre apo me letër (dyer, dritare, profile, plintuse etj) 0,55kg gëlqere e shuar.

Lyerja e tavaneve me sherbet gëlqere në disa duar deri sa të arrihet një rezultat perfekt.

Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë

Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

Lyerje me sherbet gëlqere me ngjyrë, përmban:

Fshirjen e sipërfaqes së suvatuar që do të lyhet

Mbulimin e sipërfaqeve që nuk do të lyhen me shirit letre apo me letër (dyer, dritare, profile, plintuse etj) 0,55kg gëlqere e shuar

0,01 bojë pluhur çimentito

Lyerja e tavaneve me sherbet gëlqere në disa duar deri sa të arrihet një rezultat perfekt.

Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë

Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

Lyerje me bojë vaji mbi sipërfaqe metalike, përmban:

Lyerjen me dy shtresa me bojë. Përpara lyerjes, sipërfaqja duhet të jetë kruajtur dhe pastruar mire nga të gjitha mbetjet e bojës së mëparshme.

Lyerje me bojë vaji, përmban:

Lyerjen me dy shtresa me bojë dhe dy shtresa me llak mbrojtës. Për të ruajtur ngjyrën e tij natyrale është e nevojshme që llaku të jetë pa ngjyrë. Karakteristikat teknike të llakut duhet të jenë:

Ruajta e ngjyrës dhe ndjesisë natyrale në prekje

Depërimi i mirë në material

Veprimi i shtresës së dytë të llakut duhet të jetë i gjatë në kohë

Duhet të jetë rezistent ndaj temperaturave të larta

Duhet të sigurojë parandalimin e daljes së bojës dhe prishjes së sipërfaqes

Duhet të thahet shpejt

Lyerje mure me bojë hidroplastike (brenda), përmban:

prishjen e sipërfaqes së suvatuar që do të lyhet

Mbushjen dhe veshjen e mureve të suvatuara me stoko sintetike për të përgatitur sipërfaqet që do të lyhen
Mbulimin e sipërfaqeve që nuk do të lyhen me shirit letre apo me letër (dyer, dritare, profile, plintuse etj)

Lyerja e mureve në disa duar deri sa të arrihet një rezultat perfekt.

Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë

Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

Lyerje mure me bojë hidroplastike (jashte), përmban:

Fshirjen e sipërfaqes së suvatuar që do të lyhet

Mbushjen dhe veshjen e mureve të suvatuara me stoko sintetike për të përgatitur sipërfaqet që do të lyhen

SPECIFIKIME TEKNIKE : OBJEKTI : "MIRËMBAJTJE INSTITUCIONEVE SHKOLLORE" BASHKIA POGRADEC

Mbulimin e sipërfaqeve që nuk do të lyhen me shirit letre apo me letër (dyer, dritare, profile, plintuse etj)

Lyerja e mureve në disa duar deri sa të arrihet një rezultat perfekt.

Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë

Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervisorit të punimeve

Instalimi i pajisjeve sanitare

Pajisjet sanitare do të zëvendësojnë ato ekzistuese në të njëjtat vende sikurse përpara rikonstruksionit.

Pjesët e nevojshme për fiksimin dhe mbajtjen e tyre duhet të jenë të përshtatshme për kryerjen e këtyre funksioneve dhe në përputhshmëri me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara nga prodhuesi.

Nuk do të lejohet përdorimi i mbajtëseve të improvizuara apo të një lloji tjetër nga ato të përcaktuara nga prodhuesi.

ËC allafirënga, përbëhet nga porcelan i bardhë, vida për fiksion në dysheme dhe tapa elastike.

Fiksimi kryhet nëpërmjet shufrave prej hekuri të formës L, të përshtatshme për këtë funksion dhe në përputhje me kriteret e prodhuesit. Mbajtëset prej hekuri do të fiksohen në mur dhe në dysheme me anë të pajisjeve të nevojshme për të kryer fiksion të plotë.

ËC do të shoqërohet nga:

Kapak prej materiali plastik të përforcuar, rezistent ndaj thyerjes, i cili përputhet me formën e ËC, me ngjyrë të bardhë; mbajtëse letre prej porcelani, dhe galexhat të presionit të ulët. Vendi i derdhjeve mund të jetë në dysheme apo në mur në varësi të rrjetit ekzistues të shkarkimeve dhe lidhja do të kryhet me tub plastik me diametër të brendshëm DN200. Përmasat e ËC do të jenë: lartësia 410mm, gjerësia 350mm dhe gjatësia 580mm

ËC allaturka, përbëhet nga porcelan i bardhë.

ËC do të shoqërohet nga:

Vendi i derdhjeve duhet të jetë në dysheme dhe lidhja do të kryhet me tub plastik me diametër të brendshëm DN200.

Lavaman porcelani, përbëhet nga porcelan i bardhë, në formë katrore me përmasa 58x46cm, i përshtatshëm për vendosje në mur dhe shoqërohet me elementët e mëposhtëm:

Mbajtëse të përthyera për fiksion në mur; valvul shkarkimi e nikeluar me diametër 1 1/4" me tape dhe zinxhir të lidhur me tapën dhe lavamanin; sifon.

Punime të ndryshme kanalizimi e të tjera

Tubat do të furnizohen komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa të tjera të nevojshme. Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi janë përkrahur në kapitujt e tjerë.

Përveç se modifikuar ose shtuar si këtu, të gjitha tubat PVC do të plotësojnë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, konform karakteristikave teknike Sipas SSH/EN 13476, SSH/EN 1610, SSH/EN1183, SSH/EN1133, SSH/EN527

Cdo tub duhet të ketë të shënuar në të njënyre permanente të dhënat me poshtë:

Datën e prodhimit

Emrin e prodhuesit

Shënim duhet të jete i tripezuar në tub ose i shkruar me bojë rezistente ndaj ujit.

Shtrimi në kanal

Tubacionet e PVC-se do të shtrohen në kanale.

Seksioni i kanalit do të hapet sipas permasave të dhëna në raport me thellesinë dhe dimensionin e tubacionit.

Tabani i kanalit duhet të jete i sheshtë pas germimit. Në qofte se nga germimi me eskavator nuk mund sigurohet, atëherë 20 cm-at e fundit duhen germuar me krahe.

Para vendosjes se tubacioneve do vendoset nje shtrese granili i imet (0.5cm) me trashesi 10cm.

Pas shtreses se granilit do montohet tubacioni sipas dimensioneve te dhena ne planimetrine perkatese dhe me pas do behet mbulimi i tij me granil 10cm mbi kuroren e tubit. Mbi te do behet mbushje me cakell me shtresa me trashesi 25cm. Shtresat do ngjeshen duke i shoqeruar me sperkatje me uje. Mbushja do behet deri ne kuoten ku fillojne shtresat e sistemimit të jashtëm.

Per arritjen e shtrimit te tubave PVC ne perputhje me standartet duhen marre keto masa;

- perdorimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone

Tubat PVC do te mbahen me kujdes gjate gjithë kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat me brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperafsore te bashkimevedo te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit.

Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

Germimi

Germimi per linjat e kanalizimeve do te jene sic jane specifikuar ne Seksionin (Punime Dheu) te ketyre specifikimeve teknike.

Skelerite

Çdo skeleri e kerkuar duhet skicuar ne pershtatje me KTZ dhe STAZH. Nje skelator kompetent dhe me eksperience, duhet te marre persiper ngritjen e skelerive qe duhet te çdo tipi.

Kontraktori duhet te siguroje, qe te gjitha rregullimet e nevojshme, qe i jane kerkuar skelatorit te sigurojne stabilitetin gjate kryerjes se punes.

Kujdes duhet treguar qe ngarkesa e copave te mbledhura mbi nje skeleri, te mos kaloje ngarkesen per te cilen ato jane projektuar.

Duhen marre te gjitha masat e nevojshme qe te parandalohet renia e materialeve nga platforma e skeles. Skelerite duhen te jene gjate kohes se perdorimit te pershtarshme per qellimin per te cilin do perdoren dhe duhet te jene konform te gjitha kushteve teknike.

Ne rastet e kryerjes se punimeve ne ane te rruges ku ka kalim si te kalimtareve, ashtu edhe te makinave, duhet te merren masa qe te behet nje rrethim i objektit, si dhe veshja e te gjithë skelerise me rrjete mbrojtese per te eleminuar renien e materialeve dhe duke perfshire shenjate sinjalizuese sipas kushteve te sigurimit teknik.

Skeleri çeliku te tipit kembalec, konform KTZ dhe STAZH, duke perfshire ndihmen per transport, mirembajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Ne nje lartesi mbi 12 m, elementet horizontale duhet te kene parmake vertikale, me lartesi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjete. Skeleri çeliku ne kornize dhe e lidhur, konform KTZ dhe STAZH, duke perfshire ndihmen per transport, mirembajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Ne nje lartesi mbi 12 m, elementet horizontale duhet te kene parmake vertikale, me lartesi min. 15 cm si dhe mbrojtjen me rrjete.

Ulluqe horizontale

Ulluqet horizontale do të kenë një pjerresi prej 1% për largimin e ujrave. Do të jenë PVC 33 cm dhe llamarine xingato 33cm

Ulluqe vertikale

Ulluqe vertikale për shkarkimin e ujrave të çatise në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ulluqe të rinj. Do të jenë me PVC me diametër 75 mm dhe 120 mm

Në çdo ulluk duhet të mbliidhen ujrat e një sipërfaqeje të çatise ose terraces jo më të mëdha se 80 m².

Ulluket duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës me anë të qaforeve perkatese prej PVC, të fiksuar mbi parapete çdo 2 m.

Pjesa fundore e ullukeve për lartësi 2 m, duhet të jetë PVC dhe të mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe kuba poshtë duhet të jetë e kthyer 90 grade.

Mur me tulla të plota në lartësi

Llaçi për muret për 1 m³ llaç realizohet me këto përbërje:

1. Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum

20% me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1: 0,5: 5,5. Gëlqere e shuar 92 lt, çimento 300, 212 kg, rërë 1,22 m³.

2. Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento:

gëlqere, rërë në raport 1: 0,5:5,5. Gëlqere e shuar 87 l t, çimento 300, 206 kg, rërë 1,01 m³.

Murature me tulla të plota e ngritur ose e armatuar në 3 cm, për veprat në lartësi formuar nga tulla të plota me llaç bastard m-25, sipas pikes 1.2, me dozim për m³: tulla të plota nr.400, llaç bastard m³ 0.25, çimento 400 kg 38, për çdo trashësi duke përfshirë çdo detyrë dhe mjeshteri për dhembet e lidhjes, qoshet, parmaket, skelat e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër për të dhënë fund muratures dhe për ta realizuar në mënyrë perfekte. Për muraturen e katit për dhe sipërfaqja e themelit duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi 2 cm.

Në rastin e shkolles do të ndërtohet muratura me tulla të plota për zgjatimin e oxhaqeve mbi catinë e ndertuar.

Perforcimi i kornizave të dritareve

Veshje betoni m-200 me dozim sipas pikes 2.4, në kornizat e mureve të dritareve në drejtimet dhe permasa sipas udhëzimeve në projekt, të realizuar me betonin të dhënë në veper, të shtruar në shtresë të holla të vibruara mirë, duke përfshirë kallepet, perforcimet, skelat e ndertimit ose skelerinë si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Punime murature

Ndërtim mur me blloqe betoni

Ndërtim mur me blloqe betoni 20x20x40cm, me llaç të tipit 15 dhe me dozën e mëposhtme për m³, nr. i blloqeve 60, 0.034 m³ llaç, çimento e markës 400 dhe ujë, duke përfshirë skelarinë dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin e punimeve në mënyrë më të mirë.

Suvatim i brendshëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve për murature të pastruar ose të re, me llaç çimentoje të lenget për permiresimin e ngjithjes së suvave dhe rforcimin e sipërfaqeve të muratures, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund sprucimit.

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve të sprucuara me parë ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive me anë të mbushjes me llaç bastard me shumë shtresë dhe copa tullash n.q.s. është e nevojshme edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë fund stukimit.

Suvatim i realizuar nga një trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rere e lare 0,005 m³; llaç gëlqereje m-1:2, m³ 0.03; çimento 400 kg, 6.6 ujë, të aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure dhe

e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë fund plotësisht suvatimit në mënyrë perfekte.

Suvatim i jashtëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve për murature të pastruar ose të re, me llaç çimentoje të lenget për permiresimin e ngjites së suvase dhe rforcimin e sipërfaqeve të muratures, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë fund sprucimit.

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve të sprucuara me pare ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullive me ane të mbushjes me llaç bastard me shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s. është e nevojshme edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë fund stukimit.

Suvatim i realizuar nga një trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rere e lare m³ 0,005; llaç gelqereje m³ 0.03; çimento 400 kg, 7.7 uje, i aplikuar në baze të udhëzimeve të përgatitura, në mure dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë fund plotësisht suvatimit në mënyrë perfekte.

2 PUNIMET NE FASADE

Prishja e suvatimit ekzistues deri në murin e tullës, do të kryhet larg dhe pastrami i sipërfaqes.

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullive, me ane të mbushjes me llaç bastard me shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s.

është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund stukimit. Sprucim i mureve për murature të pastruar, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjites së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke perfshire skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund sprucimit.

Suvatim dora e dyte+fino i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m² : rërë e lare m³ 0,005, llaç bastard m³ 0.03, çimento 400 kg 7.7, uje, e aplikuar, në baze të udhëzimeve të përgatitura, në mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke perfshire skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

Veshje me pllaka majolike

Për veshjen e mureve me pllaka prej materialeve të ndryshme duhet menduar se për çfarë muri behet fjale. Muret duhet të ndahen në mure të brendshme dhe të jashtme.

Sipas materialeve ndërtimore të murit dhe sipërfaqes së tij metodat e veshjes së murit mund të ndahen po ashtu në dy klasa.

- Ngjitja e pllakave me llaç (për sipërfaqe jo të drejta)
- Ngjitja e pllakave me kolle (për sipërfaqe të drejta)

Përsa i takon ngjitjes së pllakave të tipeve të ndryshme me llaç, duhet që punimet t'u përmbahen këtyre kushteve:

Baza në të cilën ngjiten pllakat e tipeve të ndryshme, duhet të jete e paster nga pluhuri dhe e qendrueshme.

Perberja e llaçit është e njëjta siç është e përshkruar më lart në pikë n 6.2.1. Trashësia e llaçit të jete jo më pak se 15 mm. Llaçi në rast se perdoret për veshjen e mureve të jashtme duhet të jete rezistent ndaj ngricës dhe koeficienti i marrjes së ujit në % të jete < 3 %. Po ashtu, llaçi duhet të plotësojë kriteret e ruajtjes së ngrohjes dhe të rezistencës kundër zerit.

Ngjitja e pllakave me kolle, behet kur sipërfaqja e bazës mbajtëse është e drejte. Kolla vendoset sipas nevojës me një trashësi prej 3 mm deri në 15 mm. Të gjitha kriteret e lartpërmendura, që duhet t'i plotësojë llaçi, vlejne edhe për kollin.

Mbasi të thahet llaçi ose kolla, duhet që fugat e planifikuara, të mbushen me një material të posaçëm (bojak). Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike (si psh silikon). Për secilin sipërfaqe 30 m² të veshur me pllaka të ndryshme, është e nevojshme vendosja e fugave levizëse.

Kushtet e punimeve me pllaka gres duhet t'u permbahen kushteve te permendura ne piken.
Te gjitha pllakat duhet te jene rezistente kunder ngrices si dhe te kene nje durueshmeri te larte.

Dritare duralumini

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç pershkruhet ne specifikimet teknike me dimensione te dhena nga kontraktori, perbehen nga material alumini, profilet e te cilit jane sipas standarteve SSH/EN 573-3 dhe jane profile te lyera perpara se te vendosen ne objekt. Ngjyra e dritares do te jete sipas kerkeses se investitorit.

Korniza fikse e dritares do te kete nje dimension 61-90 mm. Ato jane te siguruar me elemente qe sherbejne per vendosjen dhe ankorimin ne strukturat e murit, si dhe me pjeset e dala qe sherbejne per rreshqitjen e skeletit te dritares. Forma e profilit eshte tubolare me qellim qe te mbledhe gjithe aksesoret e saj. Profili i kanates se dritares do te jete me dimensione te tilla 25 mm qe do te mbulohet nga profili kryesor qe do te fiksohet ne mur.

Te dyja korniza fikse ose te levizshme jane projektuar dhe jane bere me dy profile alumini te cilat jane bashkuar me njera- tjetren dhe kane nje fuge ajri qe sherben si thyerje termike, ato jane te izoluara nga nje material plastik 15 mm. Profili eshte projektuar me nje pjese boshlleku qendror per futjen e nje mbeshtetese lidhese kendore (me hapësire 18 mm te larte nga xhami i dritares) dhe trolleys per rreshqitjen e tyre.

Ngjitja eshte siguruar nga furça me nje flete qendrore te ashper. Karakteristikat e ngjitesit kunder agjenteve atmosferike duhet te jene te provuar dhe te çertifikuar nga testimi qe prodhuesit te kene kryer ne kornizat e dritareve ose nga prodhuesit e profileve.

Profilet e aluminit do te jene te lyera sipas procesit te pjekjes lacquering. Temperatura e pjekjes nuk duhet te kaloje 180 grade, dhe koha e pjekjes do te jete me pak se 15 minuta. Trashesia e lacquering duhet te jete se paku 45 mm. Pudrosja e perdorur do te behet me resins acrylic te cilesise se larte ose me polyesters linear.

Spesori i duraluminit duhet te jete minimumi 1,5 mm. Panelet e xhamit (4mm te trasha kur xhami eshte transparent dhe 6 mm te trasha kur jane te perforcuara me rrjet teli ose me dopio xham). Ato do te jene te fiksuara ne skeletin metalik me ane te ristelave te aluminit ne profilet metalike te dritares dhe te shoqeruara me gomina. Te gjitha punet e lidhura me muraturen dhe te gjitha kerkesat e tjera per kompletimin e punes duhet te behen me kujdes. Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori per nje aprovim paraprak.

Dyer te jashtme me xham

Furnizim ne veper dere kryesore hyrjeje me xham, permasat e se ciles jane percaktuar nga ndermarrja ne kantier, ne dru pishe te stazhionuar ne menyre natyrale ose artificiale, i impenjuar, e nderruar nga: telajo e fiksuar, me seksion 6*4 cm e kompletuar me kllapa hekuri; dere me dy kanate, ku secili kanat me skelet me seksion minimal 10*4 cm e lidhur me fasho ndermjetese horizontale dhe nje vertikale me seksion te njejte dhe nje fasho te poshtme me lartesi cm 25, duke formuar dy korniza nga te cilat: nje te sipërme te formuar me xham te forte me spesor mm 4 i bllokuar ne patenten e kornizes per fiksimin e xhamit me listela, mbi te cilen nga ana e jashtme do te fiksohen hekura me seksion kuadrat cm 6.5*0.5 ne drejtimin horizontal, ne largesi nga njera-tjetra cm 23.5 dhe sipas udhezimeve te projektit dhe tjetri i poshtem i realizuar nga panele me dru pishe te stazhionuar ne menyre natyrale ose artificiale, i imprenjuar, e tera e kompletuar me te pakten dy mentesha te renda prej 16 cm per çdo kanat me lloze mbajtes te inkorporuar ne strukturen prej druri, nje brave sigurie te madhe, e pajisur me tre çelësa, doreza alumini dhe piastrat e gojezat perkatese me pllaka alumini, duke perfshire punime murature, skelat e sherbimit si dhe çdo punim tjetër per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Plintusa

Zokol plintusi ne qeramike me lartesi 8 cm dhe trashesi 1.5 cm i vendosur ne veper me llaç me dozim per m2: rere e lare m3 0.005, çimento 400 kg 4dhe uje, duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjetër per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

Pragje

Pragje lluster çimentoje te bardhe, me pike kullimi uji, te armuar ne menyre te rregullt, te llustruara ne menyre perfekte dhe me trashesi 6.5 cm, gjeresi 40 cm dhe gjatesi sipas udhezimeve ne projekt, te realizuar me beton m-200, sipas pikes 2.4, furnizuar dhe vendosur ne veper me llaç çimentoje m -1:2, sipas pikes 1.5, duke perfshire çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Pragje mermeri

Ne fillim duhet qe pjesa e pragut te dritares qe do te vendoset pllaka e mermerit te pastrohen mire si dhe te rrafshohet vendi. Pastaj duhet qe pragu i dritares dhe i deres se klases, te lyhet me qumesht çimentoje, i cili e lehteson ngjitjen e pragut te mermerit.

Trashesia e pragjeve te mermerit per dritaret te jene 2 cm. Ne anen e jashtme te dritares te kene kanal per kullimin dhe te behet zmusimi para vendosjes se tyre ne veper. Pregatitja behet sipas matjeve ne veper dhe vizatimeve.

Ngjitja e pragjeve te mermerit behet ose duke perdorur llaç çimento ose mundet qe keto te ngjiten edhe me kolle (material ngjites). Ngjitja e pllakave te mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e pllakave ne mur, pike e cila eshte pershkruar gjeresisht ne 6.1.14.

Transportet

Ngarkim dhe transport ne shkarkim, me çfaredo lloj mjete, te materialit qe rezulton nga germimet, prishjet e tj. te çfaredo natyre dhe lloji edhe neqoftese eshte i lagur, per largimin e tyre nga kantjeri ne çfaredo distance dhe niveli, duke perfshire shkarkimin dhe rrafshimin nese eshte i nevojshem.

Mure me blloqe betoni

1. Materialet dhe prodhimi i blloqeve të betonit:

Çimento, ujë, rërë dhe agregatet për prodhimin e betonit shih pikën 4.1

Blloqet me brima janë të parapërgatitura ose mund të përgatiten në kantier. Blloqet nga një prodhues i aprovuar duhet të shoqërohen me çertifikatën e prodhimit, e cila do t'i paraqitet Supervizorit.

Derdhja e blloqeve duhet bërë në kallëpe në përmasat e kërkuara, si dhe të ngjeshet mirë betoni me anë të vibratorit.

Përbërja dhe përzierja:

Përbërja e blloqeve çimento Portland e zakonshme dhe agregatët e tjerë me cilësi të aprovuar të imët dhe të ashpër me maksimumin e kokrrizës 10 mm; përzierja për blloqet që do të përdoren për mure duhet të jetë 1: 2: 4, sasia e çimentos nuk duhet të jetë më pak se 225 kg për një metër kub të betonit.

Rezistenca e blloqeve duhet të jetë: për blloqe me boshllëqe 7 N / mm²; për blloqe solide 10 N / mm²; për blloqe me brima 5 N / mm².

Mbas derdhjes blloqet duhen mbajtur të lagura mirë me ujë për një periudhë 10 ditore dhe nuk duhen përdorur para 30 ditëve nga dita e prodhimit.

Llaçi për muret me blloqe betoni duhet të jetë me përzierje 1 : 4 (1 pjesë çimento e zakonshme Portland dhe 4 pjesë rërë e cila duhet të jetë e larë. Llaçi, nëse nuk përzieret me përzierës mekanik duhet të përzieret tërësisht 2 herë I thatë dhe dy herë pasi ti jetë shtuar uji në një platformë të pastër të papërshkrueshme nga uji. Llaçi I cili ka filluar ngrirjen ose ka qënë përzier para më shumë se 30 minutave nuk duhet të përdoret apo ripërzieret.

Vendosja e blloqeve prej betoni

I gjithë punimi me blloqe duhet bërë në përmasat e treguara në vizatime

Muret duhen ngritur në mënyrë të rregullt, pa lënë asnjë pjesë më shumë se 1 metër më ulët se pjesa tjetër, vetëm nëse është marrë aprovimi për të bërë një gjë të tillë nga Supervizori. Punimi që është lënë në disnivele të ndryshme nuk do të pranohet. Në raste të mureve me kavitate, të dy trashësitë nuk duhet të jenë më shumë se afërsisht 400 mm.

Radhët e blloqeve duhet të nivelohen siç duhet. Fugat vertikale duhet të shfaqen mirë dhe këndet e detyrë, dritareve apo të qosheve të vihen në plumbçe siç duhet.

Të gjitha muret duhet të jenë të lidhur (vendosur) në përputhje me praktikën me kushtet teknike KTZ.

Të gjitha blloqet e betonit duhet të zhyten në ujë, para se të përdoren në mur dhe rreshti i sipërm i blloqeve të vendosur në mur duhet lagur, para se të rifillojë muri i ri mbi to. Faqet e mureve duhet të mbahen të pastër dhe pa llaç apo pika të tij.

Të gjitha blloqet duhen mbuluar mirë me llaç përpara se të shtrihet rreshti pasardhës dhe të gjitha fugat duhet të jenë të mbyllura dhe të qëndrueshme në të gjithë trashësinë e murit të një rreshti.

Muret që do të suvatohen t'i kenë fugat horizontale të pambushura në një thellësi prej 15 mm.

Muraturë me blloqe betoni me dimensione 0.4 x 0.2 x 0.2 m dhe llaç bastard m-25 sipas pikës me dozim për m³: blloqe betoni copë 52, llaç 0,103 m³, çimento 400 dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skela e shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për rreshtin e parë të muraturës së katit përdhe sipërfaqja e xokolaturës duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi jo më të vogël se 2 cm.

Suvatimi i brendshëm në rikonstrukcione

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërëdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Suvatim i jashtëm në rikonstrukcione

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e larë 0,005 m³; llaç bastard 0.03 m³; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Patinimi

Patinaturë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të suvatuar më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.

Lyerje me bojë plastike në rikonstrukcion

Lyerje me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme

Proçesi i lyerjes me bojë plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet.

Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes.

Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Lyerja me bojë plastike e sipërfaqeve të brendshme.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe. Lëngu i bojës hollonhet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m² sipërfaqe. Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

Lyerje me bojë akrelik i sipërfaqeve të jashtme

Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke bërë përzierjen e 1 kg vinovil të holluar me 3 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër vinovil i holluar që duhet të përdoret për 20m² sipërfaqe.

SPECIFIKIME TEKNIKE : OBJEKTI : "MIRËMBAJTJE INSTITUCIONEVE SHKOLLORE" BASHKIA POGRADEC

Më pas vazhdohet me lysterjen me bojë akreliek. Kjo bojë ndryshon nga boja plastike sepse ka në përbërjen e saj vajra të ndryshme, të cilat e bëjnë bojën rezistente ndaj rrezeve të diellit, ndaj lagështirës së shirave, etj.

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës akreliek me ujë. Lëngu i bojës hollonhet me ujë në masën 20-30%. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar. Pastaj, bëhet lysterja e sipërfaqes. Lysterja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë akreliek i holluar në 4-5 m² sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyster).

Personeli, që do të kryejë lysterjen duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lysterjes të KTZ dhe STASH.

Lysterja me bojë hidromat e sipërfaqes

Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshe. Lëngu i bojës hollonhet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj bëhet lysterja e sipërfaqes. Lysterja bëhet me dy duar.

Norma e përdorimit varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës së mëparshme.

Në ndërtime të reja para lysterjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lysterje.

Para lysterjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

Në fillim të procesit të lysterjes bëhet paralysterja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (Astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralysterja e sipërfaqes vetëm me një dorë.

Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² sipërfaqe.

Më pas vazhdohet me lysterjen me bojë si më poshtë:

-Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë.

-Bëhet lysterja e sipërfaqes. Lysterja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar në 2.7 – 3 m² sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyster).

Lysterje e sipërfaqeve metalike

Stukim dhe zmerilim të elementeve prej hekuri duke përdorur stuko të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqeve për lysterjen me bojë vaji.

Lysterje e elementeve prej hekuri, me bojë të përgatitur fillimisht me një dorë minio plumbi ose antiruxho ose në formën e vajit sintetik, me dozim per m², 0.080 kg.

Lysterje me bojë vaji sintetik për sipërfaqe metalike, me dozim per m²: bojë vaji 0.2 kg dhe me shumë duar për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lysterjes me bojë vaji në mënyrë perfekte.

Dysheme me pllaka gres

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kritereve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes

- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Peshë/ngarkesa e sipërfaqes
- Koefiçienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Marrja e Ujit në % të masës së pllakës	
Klasa	Marrja e ujit (E)
I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6 \%$
II b	$6 \% < E < 10 \%$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	shumë lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	e lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës
III	e mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	shumë e rëndë	Gastronomi, ndërtesa publike

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

Për shkolla dhe kopshte, duhet që pllakat të jenë të Klasës V, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koefiçientin e marrjes së ujit $< 3 \%$.

Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me çertifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

Dysheme me pllaka gres

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Menyra e dhenies së formës së pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Peshë/ngarkesa e sipërfaqes
- Koefiçienti i rrëshqitjes

1. Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

2. Për shkollën dhe kopshtin, duhet që pllakat të jenë të Klasës VI, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

3. Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koefiçientin e marrjes së ujit $< 3 \%$.

4. Per këte duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me çertifikaten e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

Dritare duralumini

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilat janë sipas standarteve SSH/EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara së të vendosen në objekt. Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e dritares do të ketë një dimension 61-90mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i kanates të dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: gjërësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale.

Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë bërë me dy profile alumini të cilat janë bashkuar me njëra tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike, ato janë të izoluara nga një material plastik 15 mm.

Profili është projektuar me një pjesë boshllëku qëndror për futjen e një mbështetëse lidhëse këndore (me hapësirë 18 mm të lartë nga xhami i dritares) dhe trolleys për rrëshqitjen e tyre.

Ngjitja është siguruar nga furça me një fletë qëndrore të ashpër. Karakteristikat e ngjitësit kundër agjentëve atmosferike duhet të jenë të provuar dhe të çertifikuar nga testimi që prodhuesit të këne kryer në kornizat e dritareve ose nga prodhuesit e profileve.

Profilet e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes *lacquering*. Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë 180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta. Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me *resins acrylic* të cilësia së lartë ose me polyesters linear.

Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm.

Panelet e xhamit (4mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të përforcuara me rrjet teli ose me dopio xham). Ato do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të dritares dhe të shoqëruara me gomina. Të gjitha punët e lidhura me muraturen dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me kujdes. Një model i materialeve të propozuara do të shqyrtohet nga supervizori për një aprovim paraprak.

Instalimi i Dyerve të brendshme prej duralumini:

Instalimi i dyerve të brendshme prej duralumini, dimensionet e të cilave jepen nga Porositesi, do të bëhen me anë të montimit të profileve të duralumini (korniza fikse dhe korniza lëvizëse) sipas standartit SSH/EN 573-3 dhe të lyer, kur të jenë përfunduar suvatimet e shpatullave ose vendosur veshjet me pllaka mermer etj. Të dyja pjesët (fikse dhe lëvizëse) duhet të jenë të projektuara për të bërë dyer që thyjnë nxehtësinë dhe të jenë me dy profile duralumini, të cilat bashkohen me një tjetër me anë të dy shiritave hidroizolues gome ose me material plastik.

Një kasë solide duhet të fiksohet me kujdes me anë të vidave të hekurit në mur dhe në brendësi të llaçit të çimentos. Fiksimi duhet të ketë një distancë prej qosheve jo më tepër se 150 mm dhe ndërmjet pjesëve fiksuere jo më tepër se 800 mm. Kasat fikse të dyerve do të bashkohen me kornizat pasi të ketë përfunduar suvatimi dhe lyerja. Mbushja e boshllëqeve bëhet me material plastik elastik dhe pastaj bëhet patinimi i tyre duke përdorur fino patinimi.

Kanatat e xhamit do të vendosen tek korniza e dymve dhe do të mbërthehen në tre pika ankorimi me mentesha. Gjithashtu do të vendosen edhe bravat dhe dorezat metalike ose duralumini. Mbushja ndërmjet kasës dhe murit të ndërtesës do të bëhet duke përdorur material plastiko-elastik pasi të jetë mbushur me materialin e duhur hidroizolues. Ndërmjet mbështetjes së kasës të brendshme dhe pjesës së jashtme prej duralumini është e preferueshme të mbahet një tolerancë e instalimit prej 6 mm, duke e konsideruar hapësirën e fiksimit rreth 2 mm.

Suvatim solete h~4 m me drejtues me krah dhe i lyer me bojë

Te përgjithshme:

Te gjitha sipërfaqet që do të suvatohen do të lagen më parë me ujë. Aty ku është e nevojshme ujit do të shtohen materiale të tjera, në mënyrë që të garantohet realizimi i suvatimit më së miri. Në çdo rast kontraktori është përgjegjës i vetëm për realizimin përfundimtar të punimeve të suvatimit.

Materialet e përdorura:

Llaç bastard marka-25

Llaç bastard marka 1:2

Bojë hidromat ose gëlqere.

Sprucim i tavaneve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqes të muraturës duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të bërë plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaç bastard marka-25 me dozim per m², rërë e larë 0,005m³, llaç bastard (marka 1:2) 0,03m³, çimento (marka 400), 6,6 kg, uje I aplikuar në bazë të udhëzimeve të përgatitura në mure e tavane dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit, si dhe çdo detyrim tjetër për të bërë plotësisht suvatimin me cilësi të mirë.

Lyerje dhe lemim i sipërfaqës së suvatuar të tavanit, bëhet mbas tharjes së llaçit, për tu lyer me vonë.

Lyerje e sipërfaqes me hidromat ose me gëlqere, minimumi me dy shtresa. Ngjyra duhet të jetë e bardhë dhe duhet aprovuar nga Supervizori.

Zgara hekuri

1.Zgare hekuri per dritaret, permasat e se ciles duhet te percaktohen nga ndermarja ne kantier, formuar nga : 3 hekura te sheshte te vendosur ne drejtim horizontal secili me permasa 3x1 cm, te ankoruar ne menyre te rregullt ne hapesiren e dritares dhe sipas udhezime te projektit; 6 hekura te rumbullaket te vendosur ne drejtim vertikal çdo 15 cm dhe me diameter mm14.

2.Zgare hekuri i formuar nga : 3 hekura te sheshte te permasave 3x1 cm, te vendosur horizontalisht në vepër te mberthyer me bulona te pershtatshem ne telajo; hekur me diameter mm.14 i vendosur çdo 13cm, i salduar ne hekurat e sheshte te vendosur ne anen e brendshme te arkitrarit dhe ne anen e jashtme te pragut; duke përfshirë skelat e shërbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjetër per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

3.Zgare hekuri, i formuar nga: hekura te sheshte te permasave 6,5x0,5 cm , te vendosur horizontalisht në vepër dhe të ankoruar ne murature; hekur me diameter mm.14, i vendosur çdo 30 cm ; çdo gje sipas udhezimeve ne projekt, duke përfshirë çdo veper murature, skelat e shërbimit ose skelerine si dhe çdo detyrim dhe punim tjetër per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

Pastrimi i oxhakut


Pastruesi është më i mirë për të kaluar një mot të ngrohtë, pa erë, të pastër. Frekuenca e pastrimit varet nga intensiteti i përdorimit, përdorimi i druve të zjarrit, lagështia dhe cilësia.

Para se të vazhdoni me procedurën klasike, së pari mbyllni dyert e pastrimit, derën e karburantit, derën e klases. Përpquni të lidhni një leckë të lagur në majë - ajo do të fshehë rripat ekzistues.

Duke ngjitur me kujdes çatinë, sigurohuni që të lidhni kabllon e sigurisë në një element të besueshëm të kulmit. Instrumenti kryesor i fshirjes së oxhakut është në litar, me një bandë të lidhur.

Një objekt i huaj (ndoshta një tullë kolaps, një fole zogu) konsiderohet ndotja më e vështirë. Zë shumë hapësirë në tub dhe kështu parandalon rrjedhjen e lirë të tymit në pjesën e jashtme. Për të eliminuar, keni nevojë për një shtyllë. Ata janë të shtyrë nga një objekt. Nëse kjo nuk ndihmon, atëherë përdorni një furçë të veçantë, e cila ka aftësinë për t'u zgjatur gradualisht. Në raste ekstreme, kur nuk vepron absolutisht asgjë, është e nevojshme që të çmontoj tubi.

Depozitat rrëshqitëse shfaqen në mure si ne figuren mëposhte.



HARTUAN
Përgj. Joni QAFKO
Ing. Violeta ÇEKANI
Ing. Jolka DOKO